



Periodiku AMF

I. Projekti i ngritjes së platformës elektronike të raportimit në AMF

1. Rëndësia

Rregullimi efektiv i tregjeve financiare jo – bankare është detyrë komplekse që kërkon njohuri dhe përvojë të mirë teknike, veçanërisht në drejtim të mbikëqyrjes së kujdesshme të gjendjes financiare të operatorëve të licencuar. Për të ushtruar këtë funksion me efektivitet, Autoritetit i duhet të marrë informacionin e nevojshëm mbi veprimtarinë e çdo operatori që mbikëqyr.

Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

II. 1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-qershor 2008

Në periudhën janar – qershor 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 3,210,103 mijë lekë, përkundrajt 2,716,047 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Vijon në faqen 5

II.2 Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – qershor 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – qershor 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” me 39.52% dhe vendin e dytë “Blerje në tregun primar” me 33.98% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Vijon në faqen 6

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

III. 1 Zhvillohet projekti mbi fondet e investimit dhe rregulloren e Bursës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Financial Services Volunteer Corps (FSVC), gjatë periudhës 14 – 28 Korrik 2008, zhvilloi një projekt dy javor mbi zbatimin e projektligjit të Fondit të Investimeve dhe projektregulloreve të Bursës. Ky projekt u zhvillua me pjesëmarrjen e ekspertëve, Chris Grabowski dhe Mirek Jezowski nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake dhe të Leeza Timofeeva, Drejtore Rajonale e FSVC-së.

Vijon në faqen 8

III.2 Pjesëmarrje në seminarin e katërt ndërkombëtar të mbikëqyrjes së sigurimeve, mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI), pjesë e Bankës Ndërkombëtare për pastrimin dhe rregullimin e llogarive (BIS), zhvilloi në Beatenberg të Zvicrës, gjatë periudhës 21-25 korrik 2008, seminarin e 4-t ndërkombëtar të mbikëqyrjes së sigurimeve.

Vijon në faqen 8

IV. Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

III. Kërkesat për licencim

1. Dispozitat ligjore për licencim

1.1 Dispozitat ligjore që përcaktojnë licencimin e instituteve të pensionit (dhe kur është e nevojshme edhe të planeve të pensionit) vendosen nga autoritetet përkatëse.

...Vijon nga numri i kaluar

Vijon në faqen 9

Në këtë numër:

Projekti i ngritjes së platformës elektronike të raportimit në AMF 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura 5

Ngjarje dhe zhvillime të tjera 8

Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit 9

Projekti i ngritjes së platformës elektronike të raportimit në AMF

1. Rëndësia

Rregullimi efektiv i tregjeve financiare jo – bankare është detyrë komplekse që kërkon njohuri dhe përvojë të mirë teknike, veçanërisht në drejtim të mbikëqyrjes së kujdesshme të gjendjes financiare të operatorëve të licencuar. Për të ushtruar këtë funksion me efektivitet, Autoritetit i duhet të marrë informacionin e nevojshëm mbi veprimtarinë e çdo operatori që mbikëqyr.

Burimi i parë i informacionit për Autoritetin janë pasqyrat financiare periodike të mbështetura me dokumentacion të detajuar. Grumbullimi, analiza dhe përpunimi i këtij informacioni përbëjnë sfidën më të madhe teknike në procesin e mbikëqyrjes. Duke parë rritjen e tregjeve, përfshirë këtu numrin e operatorëve dhe kompleksitetin e rreziqeve të ndërmarra prej tyre, AMF ka shqyrtuar modele të ndryshme që i shërbejnë përmbushjes së rolit të saj si rregullator i kujdesshëm drejt një mbikëqyrje të orientuar nga risku.

Në bashkëpunim me Bankën Botërore, AMF ka nisur punën për hartimin dhe ngritjen e një metodologjie të bazuar në risk për mbikëqyrjen e sigurimeve dhe pensioneve, të koordinuar me të gjitha përshtatjet ligjore të nevojshme. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar arkitekturës së teknologjisë së informacionit të AMF-së dhe zhvillimit të procedurave më efektive që garantojnë grumbullimin e informacionit të duhur dhe analizimin e tij të plotë dhe të saktë në një kohë të shkurtër.

Pas shqyrtimit të mundësive të shfrytëzimit në rritje të teknologjisë së informacionit dhe në sajë të bashkëpunimit të AMF-së me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ka nisur projekti i zhvillimit të një platforme të menaxhimit të informacionit për raportimin periodik të institucioneve financiare jo–bankare. Strategjia e zhvillimit të një qasjeje të integruar të raportimit në AMF do të mbështetet nga një platformë elektronike në dobi të punës së Autoritetit dhe vetë institucioneve financiare jo–bankare. Ndërtimi i modelit bashkëkohor të raportimit së bashku me platformën elektronike që e mbështet, po financohen nga Fondi i Ballkanit Perëndimor në mbështetje të projektit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të BERZH-it.

2. Objekti

Objekti themelor i projektit është zhvillimi i një platforme të përshtatshme të menaxhimit të informacionit që do të mbështesë procesin e mbikëqyrjes së operatorëve nga AMF. Zhvillimi i kësaj platforme përfshin (i) hartimin e specifikimeve teknike (ii) ndërtimin e formateve për grumbullimin e të dhënave dhe më tej (iii) zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm për analizimin e të dhënave. Projekti synon një trajtim efektiv dhe të drejtë të çështjeve kryesore të zhvillimit të tregjeve financiare jo–bankare në Shqipëri, me fokus të veçantë tek sigurimet e jetës dhe jo-jetës dhe menaxhimin e instituteve të pensioneve private suplementare, nëpërmjet modernizimit të sistemit të informacionit dhe raportimit. Platforma do të përdoret për grumbullimin e të dhënave dhe më tej përpunimin e tyre me synim gjenerimin e raporteve dhe evidentimin në kohë të problemeve. Ajo synon të përshpejtojë qasjen me mbikëqyrjen me bazë riskun dhe të përdorë burimet e mbikëqyrjes me efektivitet më të lartë. Zbatimi i platformës elektronike të raportimit dhe analizës synon

monitorimin nga afër të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të operatorëve në treg.

Platforma do të fokusohet tek shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensioneve. Në një të ardhme të afërt ajo do të zgjerohet pa kërkuar modifikime të mëdha edhe për mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri.

3. Synimi

Projekti synon të realizojë një zgjidhje që përmbush nevojat për grumbullimin, ruajtjen dhe analizën e të dhënave që depozitohen nga shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo-jetës dhe institutet e pensioneve private suplementare.

(I) Konsulenti i përzgjedhur nëpërmjet tenderit ndërkombëtar po punon me stafin e AMF-së për gjetjen e infrastrukturës së përshtatshme.

Bazuar në një studim të AMF-së në bashkëpunim me FSVC-në, rezulton se aplikacioni do të mund të funksionojë me një server që përdor sistemin operacional Windows dhe do të përdorë një bazë të dhënash relacionale SQL. Ky aplikacion do të hartohet në një gjuhë programimi të mbështetur lehtë nga teknologjia ekzistuese në Shqipëri. Shembuj të gjuhëve të ngjashme të programimit përfshijnë Visual Basic, Net, etj.

(ii) Vlerësimi i të dhënave që do të grumbullohen do të bëhet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe në frymën e zhvillimit të biznesit.

(iii) Parashikimi për trajnimin e punonjësve të AMF-së dhe pjesëmarrësve në treg është një nga pikat kryesore që do të mundësojë suksesin e platformës elektronike të raportimit.

(iv) Vënia në jetë e platformës elektronike të raportimit do të reduktojë kohën e AMF-së dhe operatorëve në raportimet periodike, duke rritur në të njëjtën kohë cilësinë e informacionit dhe efektivitetin e mbikëqyrjes.

Përpunimi në kohë i informacionit dhe gjenerimi i raporteve automatike me elemente të paralajmërimeve të hershme, do të ndihmojë në evidentimin në kohë të problemeve për të shmangur pasojat e pakëndshme në gjendjen financiare të operatorëve.

4. Hapat e realizimit

(I) Përcaktimi i kërkesave të raportimit

Kjo fazë synon të realizojë raportet standarde sipas kërkesave të mbikëqyrjes dhe një zgjidhje funksionale të platformës që do të lejojë krijimin e raporteve shtesë në të ardhmen nga AMF-ja. Natyra e raporteve do të shqyrtohet me kompaninë konsulente të përzgjedhur mbi bazën e vlerësimit të prioriteteve të AMF-së.

(ii) Grumbullimi i të dhënave

Faza e dytë synon hartimin e formateve të tabelave për grumbullimin e të dhënave me informacionin që i nevojitet AMF-së për të ushtruar funksionin e mbikëqyrjes. Këto formate do të përmbajnë të dhëna statistikore dhe financiare që shoqëritë e sigurimit dhe institutet e pensioneve private suplementare duhet të raportojnë në AMF, mbështetur në kuadrin ligjor. Formatet e të dhënave do të jenë në funksion të kërkesave të raportimit të përcaktuara në fazën e parë.

(iii) Hartimi i dokumentacionit teknik dhe zhvillimi i platformës elektronike të raportimit

Gjatë kësaj faze do të hartohet dokumentacioni i plotë teknik dhe do të ndërtohet platforma elektronike. Më poshtë bëhet një përmbledhje e klasifikimit të raporteve që do të gjenerohen nga platforma.

- Raportet e të dhënave bazë
Këto raporte do të përfshijnë të dhënat bazë të institucioneve të mbikëqyrura për aksionerët, organet drejtuese, adresat, etj.



- Raportet agregate të tregut

Këto raporte do të përmbledhin ato raporte të industrisë që nevojiten për publikim, ose për qëllime të krahasimit ndërmjet shoqërive.

- Raportet statistikore

Këtu hyjnë të gjithë raportet specifike me të dhëna që duhen për të bërë përmbledhjen e zhvillimit të tregjeve, ose për qëllime të raportimeve të veçanta në institucione brenda apo jashtë vendit.

- Raportet e treguesve

Këto raporte përmbajnë detaje dhe tendenca të treguesve kryesorë që përdor Autoriteti.

- Raportet e detajuara financiare

Këto raporte do të përmbajnë analiza të detajuara të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit dhe çështje që lidhen me:

- rritjen apo zvogëlimin e ndjeshëm të primeve,
- analizën e çdo ndryshimi thelbësor në biznes,
- vlerësimin e nivelit të provigjoneve teknike,
- vlerësimin e cilësisë së aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike,
- rreziqet e investimeve,
- ekspozimin e shoqërisë ndaj rreziqeve teknike të sigurimit,
- detajet e rreziqeve të mëdha të siguruara,
- ndikimin e standardeve dhe praktikave të kontabilitetit, etj.

Të gjithë elementët e raportit të detajuar financiar do të jenë baza e analizës përfundimtare të gjendjes financiare të shoqërisë së mbikëqyrur.

- Analiza të detajuara të provigjonimit të

dëmeve për shoqëritë e sigurimit

Në hartimin e këtij raporti do të shqyrtohen çështje si: tendencat e provigjonimit të dëmeve, vlerat e dëmeve dhe mesataret e tyre, duke përfshirë edhe krahasime të një shoqërie të veçantë me tendencat e tregut për të gjithë

biznesin, apo për klasa të caktuara të sigurimeve.

Këto raporte do të përmbajnë trekëndëshat e dëmeve të marrë nga shoqëritë dhe grumbullimin e të dhënave të tyre për të përcaktuar pikat e referencës, apo standardet e tregut në lidhje me:

- pagesat e dëmeve,
- vlerësimet për dëmet në proces,
- raportin e vlerës së paguar me vlerësimin,
- vlerën e dëmeve të ndodhura,
- detajet e dëmeve të mëdha.

(iv) Vënia në funksionim e platformës elektronike të raportimit

Gjatë kësaj faze do të fillojë zbatimi i platformës elektronike të raportimit. Platforma do të mundësojë edhe dërgimin elektronik dokumenteve të skanuar, apo të marrë nga sisteme të tjera.

Trajnimi teknik i stafit të AMF-së dhe përfaqësuesve të shoqërive është një nga elementët kyç në zbatimin me sukses të projektit. Seancat e trajnimeve të udhëhequra nga kompania konsulente do të do të shoqërohen me udhëzime për AMF-në dhe manuale të detajuara ndihmëse për shoqëritë e sigurimeve dhe institutet e pensioneve private suplementare në përdorimin e sistemit. Në manualin përfundimtar parashikohet të përfshihen të gjitha çështjet që do të dalin nga sesionet e trajnimit.

Projekti është parashikuar të realizohet në harkun kohor të 9 muajve.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-qershor 2008

Në periudhën janar – qershor 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 3,210,103 mijë lekë, përkundrejt 2,716,047 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 18.19% nga viti i kaluar, ku 85.16% e kësaj rritjeje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 14.84% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 39.55% të sigurimeve të Jetës dhe 16.63% të sigurimeve të Jo Jetës.

Në periudhën janar – qershor 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 4.69%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 47.64%.

Në periudhën janar – qershor 2008 u lidhën 280,075 kontrata sigurimi përkundrejt 244,496 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 255,167 nga 227,466 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL shënoi rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 9,508 kontrata ose në masën 9.03% më shumë se janar – qershor 2007.


Vlen të përmendet rritja në masën 46.26% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 24,908, nga të cilat sigurimi “Jeta dhe Shëndeti në udhëtim” ka një rritje prej 3,020 kontrata ose 53.62%, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - qershor 2008 kapi vlerën 640,277 mijë lekë, ose 17.60% më pak se në janar - qershor të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 524,105 mijë lekë, apo 84.06% të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në portofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - qershor (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2007	2008
Periudha janar - qershor		
A) Sigurim i Jetës	185,413	258,745
B) Sigurim i Jo - Jetës	2,530,634	2,951,357
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	1,827,582	1,913,376
b) Sigurimi Vullnetar	703,052	1,037,981
TOTAL	2,716,047	3,210,103

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhë janar – qershor 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar – qershor 2008 (Jo Jeta)




Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – qershor 2008

Duke i hedhur një vështrim të dhënave statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar – qershor 2008, të bie në sy që peshën më të madhe sipas llojit të transaksionit e zë “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” me 39.52% dhe vendin e dytë “Blerje në tregun primar” me 33.98% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008 u dominua në masën 96.56% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 3.44% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve, individëve apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individë me 98.61% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë 2008



Dy grupet e transaksioneve “B” dhe “C”

Transaksioni i llojit B “**Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**” ka pësuar një ulje të lehtë prej 62.82 milionë lekë ose **1.27%** krahasuar me janar – qershor 2007 dhe numri i transaksioneve të këtij lloji po ashtu ka pësuar një ulje prej **1.41%**.

Transaksioni i llojit C “**Blerje nga individët para afatit të maturimit**” ka pësuar një ulje prej 33.45 milionë lekë ose **10.95%** krahasuar me janar – qershor 2007 dhe numri i transaksioneve të këtij lloji po ashtu ka pësuar një ulje prej **2.19%**.

Kjo ulje në vlerë absolute të totalit të transaksioneve të llojit B dhe C në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2007, kap vlerën **96.27 milion lekë ose 1.83 %**.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë 2007 - 2008

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)	
Periudha janar - qershor	2007	2008	'08/'07-1	
<i>Letra me vlerë të Qeverisë</i>				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar			
	4,962.61	4,899.79	(1.27)	
	Individë	4,889.71	4,386.15	(10.30)
	Persona juridikë	72.90	513.65	604.61
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit			
	305.53	272.08	(10.95)	
	Individë	255.73	262.73	2.74
	Persona juridikë	49.81	9.35	(81.22)

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet projekti mbi fondet e investimit dhe rregulloren e Bursës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Financial Services Volunteer Corps (FSVC), gjatë periudhës 14 – 28 Korrik 2008, zhvilloi një projekt dy javor mbi zbatimin e projektligjit të Fondit të Investimeve dhe projektregulloreve të Bursës. Ky projekt u zhvillua me pjesëmarrjen e ekspertëve, Chris Grabowski dhe Mirek Jezowski nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake dhe të Leeza Timofeeva, Drejtore Rajonale e FSVC-së.

Java e parë e këtij projekti u përqëndrua mbi situatën aktuale ligjore, dhe jo vetëm, në Shqipëri lidhur me fushën e fondeve të investimeve. Ekspertët ndanë eksperiencën e tyre në këtë fushë duke bërë një prezantim të ligjit polak për fondet e investimeve.

Në ditët në vazhdim takimet u fokusuan mbi synimet që kishte Autoriteti për hartimin e këtij projektligji dhe gjithashtu në çështjet dhe problemet e mundshme që mund të vëreheshin në hartimin e tij, duke patur parasysh edhe situatën aktuale në vend.

Me interes u trajtua më shumë çështja e strukturës ligjore që do të merrnin institucione të tilla investimesh.

Java u mbyll me paraqitjen nga ana e ekspertëve e një skeme të mundshme të ligjit për fondet e investimeve, e cila mund të ishte e përshtatshme për Shqipërinë, duke patur parasysh edhe përputhjen e këtij ligji me Direktivat Evropiane.

Përveç përfaqësuesve, nga Autoriteti morën pjesë edhe përfaqësues nga studio ligjore “Kalo & Associates” dhe përfaqësues të “Raiffeisen

Bank” si një nga institucionet financiare që kanë shprehur interes në hapjen e skemave të tilla investuese.

Në javën e dytë, projekti vazhdoi me temën mbi Bursën. Përsëri pati një ndarje eksperiencash midis ekspertëve polakë dhe përfaqësuesve të AMF-së në fushën e tregtimit të titujve. Me interes u trajtua skema e Bursës polake dhe paraqitja e një skeme më të përshtatshme për Bursën shqiptare, duke përfshirë edhe alternativa të zhvillimit të kësaj burse. Më pas projekti u fokusua në diskutimin mbi kuadrin ligjor aktual në vend, të ligjit “Për titujt” dhe mbi hartimin e rregullores për Bursën e Tiranës, duke vënë theksin sidomos mbi çështje, si p.sh kompozimi i përbërjes aksionere .

Në ditën e fundit të këtij projekti u bë një përmbledhje e të gjitha fushave dhe çështjeve më problematike që u diskutuan gjatë dy javëve të projektit, e shoqëruar kjo edhe me pyetje e komente të bëra nga pjesëmarrësit në takim.

Pjesëmarrje në seminarin e katërt ndërkombëtar të mbikëqyrjes së sigurimeve, mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI), pjesë e Bankës Ndërkombëtare për pastrimin dhe rregullimin e llogarive (BIS), zhvilloi në Beatenberg të Zvicrës, gjatë periudhës 21-25 korrik 2008, seminarin e 4-t ndërkombëtar të mbikëqyrjes së sigurimeve.

Seminari u përqëndrua në trajtimin e disa prej çështjeve mbikëqyrëse thelbësore, si dhe pati si objektivi zgjerimin dhe qartësimin e mëtejshëm

të kuptimit të çështjeve lidhur me mbikëqyrjen, promovimin dhe shkëmbimin e ideve e perspektivave të ndryshme lidhur me mbikëqyrjen.

Ndër temat më të rëndësishme që u trajtuan në këtë seminar ishin: (i) Roli i standardeve ndërkombëtare, (ii) Mbikëqyrja me bazë risku, (iii) Roli i zbutjes së riskut dhe risigurimi, (iv) Metoda cilësore dhe sasiore të vlerësimit të riskut, (v) Korniza mbikëqyrëse për vlerësimin e riskut, (vi) Kontabiliteti, raportimi, publikimi e ndikimi i fazës së dytë të IFRS, (vii) Përshtatshmëria e qeverisjes së shoqërive aksionere dhe kontrollit të brendshëm, (viii) Veprime parandaluese korrektive dhe përmirësuese, etj.

Seminari u organizua në formën e prezantimeve, dhënë nga lektorë të vendeve të ndryshme, të cilët falë eksperiencës së tyre në fushën e sigurimeve arritën të trajtonin me mjaft profesionalizëm temat në program, ku nuk mungonin temat të cilat trajtonin zhvillimet më të fundit lidhur me industrinë e sigurimeve dhe mbikëqyrjen e saj. Ç'do prezantim ndiqej nga një rast studimor, i cili diskutohej dhe analizohej nga pjesëmarrësit, paraprakisht të ndarë në grupe pune.

Në fund të seminarit, pjesëmarrësit të organizuar në grupe pune, bënë prezantime rreth çështjeve të ndryshme të procesit mbikëqyrës me përqendrim në sfidat praktike që i shfaqeshin ç'do autoriteti mbikëqyrës të përfaqësuar. Vlen për tu përmendur këtu rëndësia që pati kontributi i pjesëmarrësve, të cilët përfaqësuan ato autoritete mbikëqyrëse, ku mbikëqyrja kryet me bazë risku.

Seminari u cilësua shumë i vlefshëm e në fund të tij u shpërndanë certifikata për të gjithë të pranishmit.

...Vijon nga numri i kaluar

Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

III. Kërkesat për licencim

1. Dispozitat ligjore për licencim

1.1 Dispozitat ligjore që përcaktojnë licencimin e insituteve të pensionit (dhe kur është e nevojshme edhe të planeve të pensionit) vendosen nga autoritetet përkatëse.

1.2 Gjithashtu vendosen dispozitat ligjore në lidhje me tipin e planit të pensionit dhe/ose te fondit të pensionit, që mund të krijohen dhe strukturën ligjore të instituteve të pensionit.

2. Dokumentet e qeverisjes

2.1 Planet dhe/ose institutet e pensionit duhet të kenë statute apo dokumente formale të shkruara që përshkruajnë qëllimin e planit/institutit ose parametrat e planit (si p.sh tipet e kontibuteve dhe përfitimeve), strukturën qeverisëse e dispozitat për kontraktimet ose shërbime nga palët e trea dhe gjithashtu duhet të përcaktojnë edhe të drejtat e anëtarëve e përfituesve të tjerë.

3. Menaxhimi i riskut, mekanizmat e raportimit dhe auditimit

3.1 Insitutet e pensionit duhet të kenë mekanizma të përshtatshme të menaxhimit të riskut për të adresuar në këtë mënyrë risqet e investimit, të operimit dhe të qeverisjes, gjithashtu duhet të kenë edhe mekanizma të përshtatshëm për raportimin e brendshëm dhe auditimin.



3.2 Nëse institutet e pensionit administrojnë më shumë se një fond apo plan pensioni, atyre duhet t'u kërkohet që të mbajnë llogari dhe të dhëna të veçanta për çdo plan apo fond pensioni që ato menaxhojnë.

4. Politikat financuese

4.1 Institutet e pensionit që ofrojnë një përfitim të përcaktuar (PP) dhe plane hibride/të përziera duhet të kenë politika financuese që përcaktojnë burimin e fondeve, metodën aktuale që do të përdoret dhe mekanizmat për të përmbushur kërkesat ligjore të financimit.

4.2 Në rastin kur një institut pensioni administron aktive për fonde dhe plane të ndryshme pensionesh, atëherë duhet të përgatiten politika dhe metoda financuese të veçanta për çdo plan apo fond pensioni.

5. Politikat e investimeve

5.1 Institutet e pensionit duhet të përgatisin raporte për politikat investuese.

5.2 Në rastin kur një institut pensioni administron fonde dhe plane të ndryshme pensionesh, atëherë duhet të përgatiten raporte për politikat investuese të veçanta për çdo plan apo fond pensioni.

6. Kërkesat për kapital

6.1 Në rastin kur institutet e pensionit janë të ekspozuar direkt ndaj rreziqeve financiare apo demografike, ato kërkojnë të mbajnë një shumë minimale të një kapitali fillestar të përdorshëm (të lirë) dhe të paangazhuar, ose të paktën të jenë të lirshëm të përdorin burime të përshtatshme financiare. Shuma në fjalë varet nga risku që duhet të mbulojë. Kapitali minimal që kërkohet nuk mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet e krijimit të institutit. Në mënyrë që të sigurojë funksionin garantues të kapitalit minimal, legjislacioni mund të

kërkojë ruajtjen mënjane të disa aktiveve të caktuara. Në disa jurisdiksione kërkesat e kapitalit mund të plotësohen edhe nga blerja e figuracionit, i cili ofron të njëjtin nivel mbrojtjeje për anëtarët dhe përfituesit e planit të pensionit.

7. Qeverisja

7.1 Institutet e pensionit kanë organizma qeverisës që janë përgjegjës deri në fund për institutin dhe për kodin e sjelljes të anëtarëve, të organizmit qeverisës dhe të stafit. Kodi i sjelljes mund të përcaktohet në akte ligjore të veçanta që do të zbatohen nga institutet e pensionit.

7.2 Anëtarët e organizmave qeverisës të institutit të pensionit duhet t'i nënshtrohen kërkësve të principit "fit and proper".

7.3 Institutet e pensionit mund të kërkojnë të mbajnë ndarje funksionale ndërmjet stafit që është përgjegjës për investimet dhe atij përgjegjës për kryerjen e marrëveshjeve dhe kontabilitetin.

8. Plani i biznesit

8.1 Institutet e pensionit duhet të krijojnë një plan biznesi që duhet të paktën të përfshijë (i) një listë të planeve/fondeve që instituti i pensionit do të menaxhojë; (ii) tipet e detyrimeve që instituti i pensionit propozon të marrë përsipër (p.sh garancitë e kompensimit apo përfitimin), nëse ka; (iii) shpenzimet e llogaritura dhe mjetet financiare për themelimin; (iv) zhvillimet e projektuara të fondit/planit; (v) kur është e nevojshme, mjetet për të përmbushur kërkesat e kapitalit; dhe (vi) detaje mbi menaxhimin e duhur të riskut, mekanizmat e raportimit dhe auditimit e politikat koherente të investimit që janë vendosur ose do të vendosen me hapjen e aktivitetit.

9. Heqja e licencës

9.1 Dispozitat ligjore e kërkojnë, në disa rrethana të veçanta, heqjen e licencës të një instituti pensioni.

9.2 Dispozitat ligjore lejojnë, që një instituti pensioni që i është hequr licenca në mënyrë të detyrueshme, të ketë të drejtën për apelim të vendimit për arsye rishqyrtimi.

IV. Të drejtat dhe detyrimet e autoritet licencues

10. Roli i autoritet licencues në çështjet e mbikëqyrjes

10.1 Dispozitat ligjore duhet të përcaktojnë rolin e autoritetit licencues në një sistem më të gjerë mbikëqyrës dhe rregullator. Kur ka autoritete të veçanta licencuese dhe mbikëqyrëse, atëherë duhet të lejohet që autoriteti mbikëqyrës të konsultohet në çdo aplikim për licencë.

11. Qartësia e procedurës së aplikimit për licencë

11.1 Dispozitat ligjore duhet të promovojnë një përcaktim të qartë të procedurës së aplikimit, duke përfshirë:

o informacione mbi detyrimet e autoritetit licencues, p.sh aftin kohor brenda të cilit ai duhet të marrë vendimin mbi aplikimin;

o procedurat që duhet të ndjekë autoriteti licencues për kërkimin e të dhënave të mëtejshme nga aplikuesi;

o veprimet që do të ndërmerren autoriteti licencues për të konfirmuar marrjen e informacionit si pjesë e aplikimit për licencë;

o kërkesën që stafi i autoritetit licencues të zbatojë standardet e duhura të

konfidencialitetit, përsa i përket të dhënave të mbledhura gjatë procesit të aplikimit për licencë (në përjashtim të të dhënave që duhet t'u jepen autoriteteve të tjera publike).

12. Paraqitja e dokumenteve

12.1 Autoriteti licencues duhet të ketë të drejtën të kërkojë paraqitjen e dokumenteve të qeverisjes dhe dokumente të tjera të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë së institutit me kërkesat licencuese të përshkruar në seksionin III.

13. Vlerësimi i aplikimit për licencë

13.1 Autoriteti licencues duhet të ketë të drejtën të:

o ekzaminojë strukturën e propozuar ligjore, administruese dhe të pronësisë të aplikuesit apo grupit më të gjërë të tij (nëse ka).

o vlerësojë drejtorët e propozuar dhe anëtarët e tjerë të organizmave qeverisës në lidhje me ekspertizën dhe integritetin e tyre, në lidhje me njohuritë, eksperiencën dhe precedentin penal të tyre.

o rishikojë planet e propozuara strategjike dhe operuese të aplikuesit, që:

§ të përcaktojë, nëse është vendosur në mënyrë të duhur një sistem qeverisje, menaxhim risku, kontroll i brendshëm dhe kod sjellje e

§ të konsiderojë, nëse struktura operuese e aplikuesit reflekton qëllimin dhe shkallën e sofistikimit të veprimtarive të propozuara nga aplikuesi.

o rishikojë politikën dhe procedurat që aplikuesi ka/synon të vendosë për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me detyrimet e tij sipas legjislacionit përkatës dhe me kushtet e licencës dhe të kuadrit kontrollues për

menaxhimin e riskut të krijuar nga vetë aplikuesi.

o rishikojë preventivet financiare të aplikuesit dhe të vlerësojë forcën e tij financiare dhe burimet e tjera.

o identifikojë, kur është e mundur dhe të përcaktojë përshtashmërinë e aksionerëve kryesorë, duke përfshirë pronarët kryesorë të përfitimit dhe përshtashmërinë e personave të tjerë që mund të kenë një influencë të konsiderueshme mbi aplikuesin e gjithashtu të vlerësojë transparencën e strukturës pronësore dhe burimet e kapitalit fillestar (nëse kërkohet).

13.2 Autoriteti licencues duhet që, në rrethana të veçanta, të ketë fleksibilitet në aplikimin e kërkesave ligjore, në mënyrë që tipi, shkalla dhe kompleksiteti i veprimtarisë së aplikuesit të merret në konsideratë gjatë vlerësimit, nëse ai i ka përmbushur kriteret e licencimit apo mënyrën se si i ka përmbushur ato. Rrethanat kur autoriteti licencues mund t'i aplikojë në mënyrë elastike kërkesat ligjore duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë në aktet ligjore dhe duhet të garantohet edhe mbrojtja ndaj veprimeve arbitrare nga ana e autoritetit licencues.

13.3 Autoriteti licencues mund të ketë kompetencën që t'i imponojë aplikuesit kushte për licencim dhe më pas t'i ndryshojë apo t'i tërheqë këto kushte. Rrethanat kur këto kushte do të imponohen, tërhiqen, modifikohen, përcaktohen qartë në aktet ligjore.

14. Materialet e udhëzimeve

14.1 Autoritetet e licencimit dhe të mbikëqyrjes mund t'u japin udhëzime aplikuesve në lidhje se si duhet t'i përmbushin kriteret e licencimit, që të ketë rezultate më të mira në sistemet e

brendshme (si p.sh sistemi i menaxhimit të riskut).

14.2 Autoriteti licencues duhet t'u japë udhëzime të duhura të gjithë nëpunësve që merren me vlerësimin e licencimit.

15. E drejta për refuzimin, modifikimin ose heqjen e licencës

15.1 Autoriteti licencues duhet të ketë të drejtën e refuzimit të një aplikimi, nëse kriteret nuk janë përmbushur ose informacioni i dhënë nuk është i saktë, duke mundur të kështu që procesi i vlerësimit të mbrojtë qëllimin e sistemit të licencimit. Çdo refuzim duhet të përfshijë identifikimin e kriterëve të caktuara mbi të cilat është mbështetur ky vendim.

15.2 Autoriteti licencues duhet të ketë të drejtën të bëjë rregullime të një licence, që është dhënë ose ta heqë atë kur kriteret për marrjen e licencës nuk po përmbushen në mënyrë të vazhdueshme edhe pas marrjes së saj. Këto kompetenca duhet të përcaktohen qartë në aktet ligjore.

15.3 Autoriteti licencues duhet të ketë një mekanizëm rishqyrtimi për të ekzaminuar kërkesat e instituteve, të cilëve u është modifikuar apo hequr licenca.

15.4 Vendimet e autoritetit licencues duhet të kenë mundësinë t'i nënshtrohen një apelimi administrativ dhe gjyqësor. Duhet të vendosen disa masa të përshtatshme për mbrojtjen në rast të veprimeve arbitrare nga ana e autoritetit licencues.

Për këtë numër punuan:

A. Qamo, E. Shehi, R. Guri, R. Eltari,
E. Sheri, D. Tahiraj, E. Kokona

